

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ilir Yzeiri: Përse dështoi Reforma në Drejtësi - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/ilir-yeiri-perse-deshtoi-reforma-ne-drejttesi
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:18:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 15:58:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8f8538cd5f563196235c8e25e4d2ebfbc553b390db321c921ef9803bb783875c
TEKSTI	7ffb72372c0527f3724e6f24d34d2b47115e98b37c52fa8ae34be3d95a2de04b
PAMJA	072c779097c30cb28150b65d256d9c43ff8411766845ddcbcd70c2455838ff8a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5b58094d195f00e98d15c98e76d8ff8a0f422e0dd44e492660a0919e9d4b5427
E MËPARSHMJA	4a240f46a4fadfb7630164972c0aa0ec6c1de02caaae7c1cbc24401803007319
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5b58094d195f00e98d15c98e76d8ff8a0f422e0dd44e492660a0919e9d4b5427>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Analiza: Me rihapjen e shkollave ndizet edhe debati për hixhabin në Azinë Qendrore



Opinion

Ilir Yzeiri: Përse dështoi Reforma në Drejtësi

Nëse shtetarët tanë nuk frymëzohen nga shembujt e njerëzve të mëdhenj që kanë bërë reforma të thella në vendin e tyre dhe që kanë promovuar ligjin, mirëqenien, jo pasurimin, nëse nuk ndëtojmë një shtet që ta shohë hapësirën publike si pronë që duhet ruajtur dhe jo si plaçkë që duhet shqyer, atëherë.....



Foto ilustruese



Ilir Yzeiri

8 Shtator, 17:54 | Përditësimi: 8 Shtator, 17:58

f Share Tweet



A A

Kriza e fundit dhe përplasia mes qeverisë dhe sistemit të drejtësisë në vend, për shkak të kërkesës së tyre për rritje pagash dhe kundërshtimit të qeverisë që ta llogarisë atë shtesë sipas oreksit të punëtorëve të drejtësisë së re, është vetëm ana më e trishtë e panoramës së sistemit të drejtësisë në vend.

Tani nuk ka më asnjë dyshim që reforma më e mbështetur nga shqiptarët dhe më e votuara nga parlamentarët, jo vetëm që ka dështuar, por është kthyer në një minë me sahat për demokracinë shqiptare, sepse trupa që e përbën atë ka dalë jashtë çdo kontrolli dhe ata sillen me këtë vend si të ishin pushtues.

Edhe vetë kryeministri, që deri vonë e shpallte Reformën në Drejtësi si arritje personale të tijën dhe të forcës politike që ai përfaqëson, po e përmend, herë pas here, në një formë jo eksplicite, dështimin e saj. Po përse ndodhi kështu? Përse një nga reformat më të kërkuara dhe më të domosdoshme u shfityrua dhe në vend që ta shëndoshte sistemin, e kalbi më keq atë.

[Sh]
.com



LEXO EDHE:

'Balluku', Bardhi: Dikush t'i kujtojë SPAK-ut se ende nuk ka sjellë në Parlament kërkesën për heqjen e imunitetit

Arsyet mund të jenë të shumta, por në këta vjet mjaft ekspertë seriozë dhe të paanshëm, kanë treguar me fakte se çfarë shkoi keq me atë reformë. Gjëja e parë që të bie në sy dhe që duhet korrigjuar menjëherë është se shkatërrimi i godinës së vjetër dhe ndërtimi i godinës së re të drejtësisë iu la sistemit nga brenda, pra iu la magjistratëve, një pjese prej tyre, të cilët duhet të përgjigdhnin pjesën "më të mirë".

Pavarësisht se në atë proces kishte edhe ekspertë të huaj, prania e njëres palë për të zgjedhur një palë tjetër, në një vend me përqindje të lartë familjariteti, miqësie, klientelizmi e korrupsioni, pra, vetingu i famshëm, siç po del tani, shërbeu në një pjesë të konsiderueshme për të larguar një kastë juristësh e për të promovuar një tjetër në emër të drejtësisë së re. Dhe këtu mes shembujve tronditës mund të përmendim që lihet jashtë sistemit të drejtësisë një nga gjyqtarët më me integritet Gurali Brahimllari dhe promovohet Olsi Dado.

Në komisionet e ngritura për të promovuar drejtësinë e re, shtypi ka vërejtur në më shumë se një rast abuzimet e Ina Ramës. Por pavarësisht emrave, ajo që ka rëndësi është të vihet re produkti dhe predispozicioni i institucioneve që u krijuan pas miratimit të Ligjit për Drejtësinë e Re. Në këtë rast vihet re një dukuri.

Në kulturën e shtetndërtimit shqiptarët ende nuk kanë krijuar vetëdijen e ndarjes mes shtetit dhe individit. Nëse sot ne duam të krijojmë modelin e Prokurorit apo të Gjyqtarit të Republikës, ne zgjedhim modelin ligjor më të avancuar. Këtë e bëjmë se jemi naivë dhe mendojmë se duke marrë kallëpin e një modeli të përparuar evropian, e kemi shëndoshur edhe sistemin. Harrojmë se brenda atyre kallëpeve do të futen magistratët shqiptarë dhe gjysma e atyre që shpëtuan nga vetingu. Ka nga ata që kanë edhe integritet moral dhe përpiqen të zbatojnë ligjin.

Por, në shumicë, veçanërisht prokurorët e [SPAK](#)-ut dhe gjyqtarët e [GJKKO](#)-së treguan në këta vjet se modeli për ta është vetëm mburoja për të justifikuar egozmin dhe prapavijat e frustrimit politik apo social. Nëse e drejta për të dyshuar është një mundësi juridike, ajo nuk mund të kthehet në një normë të vetme dhe burgjet nuk mund të mbushen me të dyshuar sepse kështu do të kthehemi ose më saktë jemi kthyer në kohën e Mon Kukaleshit ku po të kishe xhepat e mufatun kishe bomba.

Paradoksi me sistemin e ri të drejtësisë është jo vetëm tejkalimi i së drejtës, por edhe protagonizmi përjashtues në emër të pavarësisë institucionale. Në një shtet të së drejtës askush nuk është i pavarur.

Në një shtet të së drejtës të gjithë janë të varur nga një zinxhir ndalimesh që i pengon ata të realizojnë me firmën e tyre atë që është në dëm të interesit publik. Me Reformën në Drejtësi, me ndryshimet kushtetuese që u bënë me këtë rast, në Republikën e Shqipërisë vetëm një kategori nëpunëshish të lartë janë mbi presidentin, mbi kryeministrin e mbi të gjithë : ai është prokurori i SPAK-ut. Atë askush nuk e heton dhe askush nuk e ndalon nëse ai mund të çmendet një ditë e të bëjë ato që po bën tani. Po çfarë reforme është kjo ? Si mund të prishet parimi i shenjtë i check and balance ?

Ana qesharake e reformës janë institucionet që janë krijuar për ta monitoruar, promovuar e kontrolluar atë. Të gjithë po e shohim se çfarë po ndodh në KLP për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm. Në atë proces jo vetëm që ka humbur solemniteti që do të duhej të buronte nga reforma e thellë, por po shfaqen më të errëta se më parë dyshimet për blerjen e postit me anë të influencave. Si mund ta luftojë korrupsionin një prokurori që del nga kjo strukturë ? Dhe e fundit është përplasja për pagat. Secili është në të drejtën e tij që të kërkojë të shpërblehet sa më mirë.

Por, në një vend që thirret ende i varfër ose më i varfri i Europës, të kërkojë paga të larta mbi të tjerët në një kohë që ti je sistemi më i përfolur për korrupsion, në një kohë që gjyqtarët dhe prokurorët e këtij vendi, nga '90 e këtej (natyrisht jo të gjithë), por në pjesën më të madhe gëzojnë pasuri e komoditet të mjaftueshëm, pra të kërkojë përsëri rritje page, kjo e tejkalon atë që në ngjarje apo në një tipologji quhet ana subjektive krahas anës objektive.

Në sytë e opinionit publik figura e punëtorit të drejtësisë merr një goditje të rëndë, sepse opinioni ka të drejtë të pyesë : çfarë u bë me ata prokurorë e gjykatës që u gjendën nga vetingu me pasuri marramendëse ? Ku janë sot ata ? Disa janë bërë politikanë si [Gjin Gjoni](#), të tjerë kanë mbetur brenda sistemit dhe mesa duket kanë edhe ata vetëm një parim- jo të japin drejtësi por të bëjnë lekë.

Për fat të keq, Shqipëria nuk ka më heronj as modele për të ndjekur. Ai që merret me biznes, për opinionin e përgjithshëm, është ai që ka forcën, që i imponohet shtetit dhe që nuk përfill ligjin. Modeli i pasurimit me çdo kusht dhe etja për të fituar promovohen nga çdo anë e hapësirës publike. Ndaj të huajt çuditën me paradoksin se çfarë është private është super luksoze- hotel, restorant, banesë.

Sapo del në rrugë pastaj, pra sapo nis hapësira publike fillon kaosi, pluhuri, papastërtia dhe "bjeri t'i biem". Nëse shtetarët tanë nuk frymëzohen nga shembujt e njerëzve të mëdhenj që kanë bërë reforma të thella në vendin e tyre dhe që kanë promovuar ligjin, mirëqënien, jo pasurimin, nëse nuk ndërtojmë një shtet që ta shohë hapësirën publike si pronë që duhet ruajtur dhe jo si plaçkë që duhet shqyer, atëherë të gjithë do të kërkojnë të ndërtojnë zotërimet e tyre në këtë vend, ashtu siç po bëjnë punëtorët e drejtësisë së re.

U.D/Shqiptarja.com

TAG: [ilir yzeiri](#) [reforma ne drejtesi](#) [gjin gjoni](#) [spak](#) [GJKKO](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



4.0 / 5 (12 vlerësime)

OPINIONET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Biku:

08/09/2026 18:25

Bravo Ilirio, e fitove edhe ti suflaen e sotme

Përgjigju



Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Rregullorja censuruese e GJKKO/ OSBE për Report TV: Kufizimet e përgjithshme të vendosura ndaj medias shkelin parimin e transparencës të zgjedhur nga KLGJ

19 Shtator, 09:54



Veliaj thyen këmbën duke luajtur futboll në paraburgim, lë qelinë dhe shkon në spital për mjekim!

18 Shtator, 18:26



PD akuza Ramës dhe Nufit: Shqipëria tregti armësh në vende në konflikt, shkelje e rregullave të NATO-s dhe BE-së! SPAK të hetojë

18 Shtator, 16:55



Dosja 'AKSHI'/ Zhduku 950 mijë euro verëra të sekuestruara në vilën e Ergys Agasit, GJKKO në lë burg kushëririn e tij, Eno Agasi



Keti Banushi

18 Shtator, 13:51



Ngërçi me pagat në sistemin e drejtësisë, drejtoresha e Thesarit jep 'llogari' në SPAK

18 Shtator, 10:54



GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, Haxhia: Qëndrim i turpshëm, përshkallëzojmë bojkotin

17 Shtator, 15:27



GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatojeni, ose ndiqni rrugët ligjore! Haxhia: Përshkallëzojmë bojkotin (DOKUMENTI)



Keti Banushi

17 Shtator, 11:09



Dosja 'AKSHI'/ Zhduku 950 mijë euro verëra të sekuestruara në vilën e Ergys Agasit, arrestohet në Tiranë kushëriri i tij, Eno Agasi!

16 Shtator, 19:10



Emaillet me Ballukun, pyeten në SPAK dy vëllezërit Eftimi! Studio e tyre e arkitekturës projekttoi vilën e sekuestruar në Palasë

16 Shtator, 17:21




Trafikoi qindra kilogramë drogë me djalë e Breçanit, Gjykata e Brazilit pranon ekstradimin e Ervin Matës drejt Shqipërisë

16 Shtator, 08:46



Gjykata e Lartë la në qeli Veliajn/ Duraj: Sot ai duhet të ishte ulur në tryezën e kryebashkiakut! Karanxha: Në Shqipëri është bërë modë mosrespektimi i vendimeve të



Ylli Pata: Drejtësia, si flamur i flamingove?



Ylli Pata

15 Shtator, 21:03

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.